



Nr.5

ISSN 2521-831X

BULETINI MUJOR

KLIMATIK

Maj 2017



Universiteti Politeknik i Tiranës

Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit & Mjedisit

Tirana © 2017



BULETINI MUJOR

KLIMATIK

MAJ 2017
Nr. 5

Vlerësimi meteorologjik për muajin maj 2017

Gjatë muajit maj 2017 territori i vendit tonë u karakterizua me kalimin e një sërë frontesh atmosferike, që në tërësinë e tyre nuk përcollën dukuri ekstreme të motit gjatë kësaj periudhe. Ndërkohë, në javën e tretë në veçanti, pati një mbizotërim të motit të paqëndrueshëm duke u shoqëruar me reshje kryesisht në orët e mesditës, falë influencës së situatës së krijuar nga ardhja e një fronti të ftohtë pjesën veriore të gadishullit Ballkanit; prania e të cilit u reflektua për disa ditë dhe në vendin tonë (shih figurën Nr.1). Gjithsesi vlen të evidentohet fakti që edhe gjatë muajit maj 2017 vijuan të ruhen vlera mujore më të larta rreth 0.7°C të temperaturave të ajrit kundrejt vlerave të normës. Reshjet në tërësinë e tyre në shkallë vendi shënuan vlera pranë madhësive përkatëse të normës dhe me ndryshime të vogla, referuar dhe krahasuar gjithnjë me periudhën shumëvjeçare 1961-1990.

Figura Nr. 1 – Paraqitet prania e qendrës me presion të ulët atmosferik, nën ndikimin e së cilës u përfshi dhe një pjesë e mirë e territorit të vendit tonë, më datë 25 maj 2017.

















Figura Nr. 2. Situata sinoptike e datës 31 maj 2017, ku dallohet qartë prania dhe ndikimi i fushës barike me vlera të larta të trysnisë atmosferike, që përcolli në fund të muajit maj një mot të kthjellët e pa reshje në mbarë territorin e vendit tonë.

Vlerësime për ecurinë e temperaturës së ajrit dhe reshjet (figurat në vijim Nr. 3/1÷3/12) në disa prej vendmatjeve meteorologjike të **Sistemit Kombëtar të Monitorimit Meteorologjik** për muajin maj 2017.





KARAKTERISTIKAT KRYESORE KLIMATIKE TË MUAJIT: MAJ 2017



Vlerësimi i reshjeve në shkallë kontinentale nga Qendra e Parashikimit të Klimës në NOAA paraqitet në figurën në vijim Nr.4, ku vërehet qartë se Europa në tërësinë e saj ka patur përgjithësisht rreth 50 deri 200 mm reshje, kryesisht në formë shiu dhe me një shkallë të lartë uniformiteti në shpërndarje hapësinore, gjatë periudhës 30 ditore 1-30 apo 2-31 maj 2017. Këto vlerësime, të cilat gërshetojnë një sërë burimesh informacioni satelitor, gjithsesi kanë nevojë dhe për një korrektim dhe verifikim me të dhënat tokësore.

Figura Nr. 4 - Shuma e reshjeve të rëna për periudhën 30 ditore 1-30 maj 2017 në kontinentin Evropian.

Gjithsesi një rëndësi të veçantë kanë dhe vlerat e anomalive të reshjeve referuar periudhës klimatike 1981-2010, të cilat janë paraqitur në figurën Nr.5. Duhet thënë se shmangiet ndaj kësaj periudhe, që kanë patur vlerat e reshjeve



të vrojtuar gjatë periudhës (30 ditore) 1-30 maj 2017 kundrejt periudhës së sipër përmendur tregojnë se në tërësi kontinenti evropian shënon vlera nën normë, në pjesën më të madhe të hapësirës.

Ndërkohë, siç shihet dhe në figurë Nr. 5, vendi ynë rezulton me reshje lehtësisht mbi normë për pjesën qendrore e jugore.

Figura Nr. 5 – Anomalitë e shënuara në sasinë e reshjeve të rëna për periudhën 1-30 maj 2017 në kontinentin Evropian kundrejt periudhës 1981-2010.

Shqipërinë u realizua duke përdorur një sërë të dhënash nga vendmatjet e Sistemit të Monitorimit Kombëtar Meteorologjik. Nga përpunimi i të dhënave të 50 vendmatjeve përfaqësuese dhe të përzgjedhura për të gjithë territorin e vendit mbi ecurinë e elementëve meteorologjikë të reshjeve dhe të temperaturës së ajrit për muajin maj 2017, duke bërë dhe krahasimet e nevojshme me tregues të ndryshëm të vlerësimit të karakteristikave klimatike, siç janë temperaturat mesatare maksimale, minimale, numri i ditëve me reshje mbi pragun $>1.0\text{mm}$, lartësia e reshjeve mujore, reshjet maksimale 24 orëshe, etj., u mundësuan grafikët e pasqyruar në vijim si dhe përfundimet si më poshtë vijon:

- Muaji maj 2017 nga pikëpamja e ecurisë së temperaturave të ajrit shënoi në shkallë vendi vlera paksa mbi normë (figura Nr.6), kjo dhe falë mbizotërimit të masave ajrore dhe fronteve atmosferike, që herë pas here me alternimin e tyre përcollën mot me vranësira e reshje. Kësisoj sa i takon temperaturave nuk u arrit një diferencë me rreth $+2^{\circ}\text{C}$ më lart se norma; ajo çka pritej nga shumë modele të parashikimit të motit apo dhe është shënuar shpesh në vitet e fundit edhe për muajin maj.
- Sa i takon reshjeve u vrojtuan vlera pranë normës dhe pa ndonjë specifike të veçantë (figura Nr.7). Numri i ditëve me reshje rreth 7 deri 10 ditë, në tërësi ishte pranë vlerave të normës siç tregohet dhe në figurën Nr.8, por brenda normalitetit përkatës të luhatjeve të këtij treguesi. Reshjet maksimale 24 orëshe paraqitur në figurën Nr. 9 ishin pranë vlerave 20 deri 40 mm dhe vetëm në pak raste ato shënuan vlera të regjistruara deri në 50-55mm gjatë 24 orëve, por duke mos shënuar në asnjë rast situata me intensitete të larta dhe krijuar problematika.




Figura Nr. 6 – Temperaturat mesatare mujore të ajrit për muajin maj 2017 dhe vlerat e normës për 26 vendmatje të Sistemit Kombëtar të Monitorimit Meteorologjik.




Figura Nr. 7 – Lartësitë mujore të reshjeve të përpunuara dhe vlerësuar për muajin maj 2017 dhe ato të normës referuar periudhës 1961-1990.




Figura Nr. 8 – Numri i ditëve me reshje të vlerësuar për muajin maj 2017 dhe vlerat e normës referuar periudhës 1961-1990.






Figura Nr. 9–Reshjet maksimale 24 orëshe për 50 stacione meteorologjike të përpunuara për muajin maj 2017.

VLERËSIME MBI SITUATËN METEOROLOGJIKE TË PRITSHME PËR MUAJT NË VIJIM.

TEMPERATURA E AJRIT - Në hartën në vijim jepet një pasqyrë e shpërndarjes hapësinore të probabiliteteve më të mundshme për temperaturat e ajrit, të pritshme në hapësirën e kontinentit evropian për muajt korrik, gusht dhe shtator 2017. Vihet re se pjesa qendrore e kontinentit dhe ajo në veri të vendit tonë duket se do të kenë vlera pranë normës ose nën të, ndërsa pjesa tjetër do të vijojë të ruajë si dhe më parë vlera mbi normë.




RESHJET ATMOSFERIKE - Në tërësi duhet thënë se kontinenti do të ruajë karakteristika më pranë thatësisë për muajt në vijim: korrik, gusht e shtator, ku reshjet pritet të jenë nën normë. Kjo është e vlefshme dhe për vendin tonë, ku probabilitetet shënojnë vlera të pritshme për reshjet lehtësisht nën madhësitë e normës shumëvjeçare.



INFORMACIONE TË TJERA

Energjitë e rinovueshme.

Harta e Shqipërisë në të djathtë paraqet vlerat mesatare për shpejtësinë e erës në lartësinë 120 m nga sipërfaqja e tokës për muajin qershor (në m/sek). Kjo hartë është produkt i vlerësimit nga zbatimi i modeleve të caktuara, të cilat mbajnë në konsideratë një sërë faktorësh, që kanë të bëjnë me qarkullimin e atmosferës, informacione satelitore, matjet tokësore, etj. Me aplikimin e software-it përkatës të "Sander & Partner", u përgatit nga Prof. Petrit Zorba, harta në fjalë për këtë buletin, që përbën një burim të rëndësishëm informacioni, kur bëhet fjalë për vlerësimin dhe shfrytëzimin e energjisë së erës.



Për të shfrytëzuar maksimumin e energjisë së erës, disa projekte të reja "Start Up"-e, të bazuara në parimin e ngjashmërisë me qeniet e gjalla kanë filluar të realizohen në ditët e sotme. Këto sisteme imitojnë pak a shumë fluturimin e kolibrit, një zog i cili administron në mënyrë perfekte fluturimin "në vend", falë rrahjes së shpejtë të krahëve në mënyrë vertikale në formën e shifrës 8. Në ngjashmëri me të, pajisjet e ndërtuara transformojnë lëvizjen vertikale në rrotulluese duke mundësuar një konvertim të energjisë deri në 80%. Krahët janë ndërtuar me fibra karboni dhe kanë gjatësi 1.6 m. Për çdo njësi ofrohet një fuqi prej 1kW për shpejtësi ere 10m/sek. Këto sisteme janë në fazë testimi dhe paraqiten më pak të dëmshme për zogjtë që fluturojnë pranë tyre.*

**Përkthyer e përshtatur për këtë buletin nga Prof. Petrit Zorba
("Science et Vie", Nr.1196, Mai 2017).*



Për të lexuar buletinet e tjera jeni të mirëpritur të vizitoni faqen përkatëse, duke klikuar në link-un e IGJEUM-it.



<http://www.geo.edu.al>



☀ ☀ ☀
Ky “Buletin Mujor Klimatik” u përgatit nga
Departamenti i Klimës dhe Mjedisit të
IGJEUM-UPT.
Tiranë © 2017.

